



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

**AD-GJTHPZ.nr.9/22**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, kryetarja e gjykatës, Shpresa Emra (Autoriteti Kompetent), duke vepruar sipas ankesës së të akuzuarit D.S., nga Gjakova parashtruar kundër gjyqtarit F.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur në bazë të së cilës është bërë iniciimi i procedurës disiplinore, me dt.04.10.2022, mori këtë:

### **AKTVENDIM**

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e të akuzuarit D.S., nga Gjakova parashtruar përmes Këshillin Gjyqësor të Kosovës, tek Autoriteti Kompetent kundër gjyqtarit F.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren për iniciimin e procedurës disiplinore.

### **Arsyetim**

Parashtruesi i ankesës i akuzuari D.S., nga Gjakova në ankesën e parashtruar kundër gjyqtarit Fatmir Krasniqi, ka cekur se në veprimet e gjyqtarit të lartcekur ka pasur veprime procedural të njëanshme dhe se nuk i trajton siç kërkohet me ligj palët në procedure , përfaqësuesit e tyre , dëshmitarët dhe pjesëmarrësit të tjerë në procedurë. Ka cekur se gjyqtari ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë për dëgjim të dëshmitarit I cili nuk ka lidhje me rastin dhe është familjar i të dëmtuarës për të cilën gjë konsideron se i njëjti është i njëanshëm në këtë gjykim dhe e dëmton procesin në tërësi.

Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka iniciuar hetimet për procedure disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shiqimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës dhe pasi ka analizuar pretendimet ankimore, ka konstatuar se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkretë nuk ka pasur bazë për shkelje disiplinore në rastin konkret pasi që gjyqtari gjatë zhvillimit të procedurës ka të drejtë të aprovojë propozimet e palëve, si të prokurorit ashtu edhe të akuzuarit , zhvillimi i procedurës është në rrjedhë e sipër dhe ende nuk ka përfundim të çështjes dhe në këtë drejtim gjyqtari duhet të vlerësojë çdo prove e cila parashtrohet nga palët në mënyrë që të jep vendimin meritore. I akuzuari nëse nuk është i kënaqur me vendimin e gjyqtarit mund të kundërshtojë propozimet e parashtruara në shqyrtim, por gjyqtari sipas ligjit vendos për këto propozime. I akuzuari gjithashtu ka të drejtë në ankesë në fund të shqyrtimit kur të vendoset në mënyrë meritore të ankimojë edhe këto vendime procedurale të gjyqtarit. Bazuar në të lartcekura në rastin konkret nuk janë përmbushur

dispozitat nga shkeljet disiplinore për gjyqtarë të paraparë nga neni 5 i Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve nr. 06/1--067.

Për arsyet që u cekura më lartë, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**AD-GJTHPZ.nr.9/22 me dt. 04.10.2022**

**Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren**

Gjykatës Themelore në Pr

Shpresa Emra

arë e drejta e ankesës.

**KËSHILLA JURIDIKE:** *Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.*